



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-128

Prishtinë, më 2 tetor 2013, në orën 10: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 2 TETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga: OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe deputetëve të tjerë për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me përmbajtjen e kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe deputetëve të tjerë, që kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 3 tetor 2013.

Kërkesën e lartshënuar, në emër të parashtruesit, e arsyetoi kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 3 tetor 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbali e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale